



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Beledijesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova-Republic of Kosovo Mamuša Beledijesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa	
Çikës - Dalëse - Izlazna - Outgoing	
02	No.Nr. 96-25
05.06.2025	



Në bazë të paragrafit 6 të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 si dhe nenit 63 paragrafi 63.1.1 pika (b) të Rregullores Nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik lidhur me kërkesën për rishqyrtim të datës 03.06.2025 të paraqitur nga Operatori Ekonomik MEDPLUS SH.P.K. nga Prishtina, bie këtë :

VENDIM

I

Refuzohet **si e pa bazuar** kërkesa për rishqyrtim e Operatorit Ekonomik MEDPLUS SH.P.K. nga Prishtina e parashtruar në mënyrë elektronike përmes platformës së prokurimit me datën 03.06.2025 për aktivitetin e prokurimit me numër: 626-25-4792-1-3-6 dhe nr. të brendshëm: 626-25-005-1-3-6 me titull: “FURNIZIMI ME MATERIAL SHPENZUES MEDICINAL PËR LABORATOR TË QKMF-s NË MAMUSHË”

II

Anulohet njoftimi për pezullim të procedurës së prokurimit i datës 04.06.2025 pas paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim.

III

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

ARSYETIM

Operatori ekonomik MEDPLUS SH.P.K. nga Prishtina me datë 03.06.2025 përmes platformës elektronike, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim të vendimit për njoftimin e kontratës për procedurën e prokurimit me titull dhe nr. të prokurimit të lartcekur.

Si autoritet kontraktues pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim, kemi bërë pezullimin e kësaj procedure dhe brenda afatit ligjor me kujdes të shtuar, kemi shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim të vendimit.

Në pretendimet e O.E. është cekur se janë bërë shkelje të neneve 1; 6; 8; 27 dhe 28 të LPP-s si dhe neni 5; 17 dhe 26 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik. Konsiderojmë që të gjitha këto pretendime të shkeljes së LPP-s janë të pa baza për arsyet e cekura në vijim.

Ne nuk kemi bërë shkelje të asnjërës dispozitë të lartcekur nga Operatori Ekonomik sepse nuk kemi favorizuar dhe nuk kemi diskriminuar asnjë operator ekonomik. Ne kemi përdorur procedurën e kuotimit të çmimit sipas LPP-s e cila është procedurë transparente dhe nuk e diskriminon asnjë O.E. pasi që janë vendosur kërkesat në përshtatje me legjislacionin e prokurimit.

Në bazë të kërkesës për rishqyrtim, vërejtëm që pretendimet kryesore janë për artikujt e kërkuar në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë për këtë procedurë të prokurimit të publikuar me dt. 02.06.2025. Duke pasur parasysh që procedura e prokurimit me titull “Furnizimi me material shpenzues për laborator dhe material shpenzues dentar me nr. prokurimit: 626-24-5207-1-2-1, nuk ka mundur që të përfundoj për shkak të ankesave dhe kthimit në rivlerësim të tenderit për herë të katërt e cila ka marrë një kohë mbi një (1) vjeçare dhe ende nuk është përfunduar procedura e prokurimit në fjalë, është paraqitur nevoja urgjente që të furnizohemi me material shpenzues për laborator pasi që laboratori në QKMF të Mamushës pa këto materiale nuk mund t’i kryej shërbimet. Rrjedhimisht qytetarët kanë mbetur pa marrjen e shërbimeve.

Sa i përket procedurës me nr. të prokurimit: 626-24-5207-1-2-1 ne në vendimin e datës 29.07.2024 për anulim të procedurës kemi sqaruar se procedura në fjalë është anuluar për shkak të gabimeve në specifika teknike dhe përqindjes së dhënë në para-masë nga njësia kërkuuese për disa pozicione të caktuara. Gjithashtu gjatë shqyrtimit të kërkesës së O.E. për rishqyrtim, kemi shpjeguar që njësia e kërkesës gabimisht ka dërguar specifikat teknike për pajisjet të cilat janë hequr nga përdorimi.

Andaj produktet në pozicionet e kërkuara në procedurën e prokurimi me nr. 626-25-4792-1-3-6 nuk janë të njëjta me produktet e kërkuara në procedurën që është në rivlerësim pasi që ne me këtë procedurë jemi duke kërkuar që të lidhim një kontratë për një furnizim me materiale për pajisjet ekzistuese e për të cilat kemi nevojë urgjente.

Pra nuk qëndron pretendimi i O.E. që në dosje të tenderit, janë ndryshuar paksa emërtimet apo doza e disa produkteve në krahasim me produktet që janë pjesë e tenderit ku lënda është kthyer në rivlerësim me vendim të OSHP-së, dhe nuk qëndron pretendimi që është konfirmuar se ne e kemi anuluar pa bazë ligjore tenderin përkatës pasi që ankesa e O.E. është aprovuar si pjesërisht e bazuar dhe lënda është kthyer në rivlerësim për të hulumtuar tregun në lidhje me çmimet jo normalisht të ulëta të paraqitura nga O.E. ankues.

Ne si AK nuk kemi bërë kurrfarë veprime kundërligjore, tendencioze dhe diskriminuese ndaj kompanisë ankuese por qëllimi i AK-s është që të furnizohemi me materialin e domosdoshëm për t’i ofruar qytetarëve shërbimin për kryerjen e analizave pa të cilin QKMF në Mamushë nuk do të mund t’i kryej shërbimet.

Për shkak të nevojave urgjente ne kemi mundur që të zhvillojmë një procedurë pa publikim të kontratës, mirëpo për të qenë transparent dhe për t’ia mundësuar konkurrimin secilit O.E. dhe për ta kryer furnizimin vetëm me materiale të cilat nevojiten urgjent, kemi zgjedhur që të iniciojmë këtë procedurë për kuotim të çmimit vetëm për një furnizim dhe jo kontratë kornizë për disa vite, ndërsa procedura tjetër e cila është në rivlerësim sipas vendimit të OSHP-s do të vazhdoj pasi që nga OSHP është kërkuar që të bëhet hulumtim i tregut në lidhje me çmimet e ofruara nga ana e O.E. ankues.

Duhet të theksojmë që kjo procedurë nuk do të ndikojë në vendimin e AK-s për procedurën tjetër sipas pretendimit të O.E. pasi që ne si AK nuk kemi për qëllim diskriminimin e askujt dhe për këtë qëllim kemi publikuar njoftimin e kontratës në mënyrë që të jetë një konkurrencë e hapur në të cilën pa kurrfarë problemi mund të marrë pjesë edhe O.E. ankues.

Pas pranimi të kërkesës për rishqyrtim zyra e prokurimit ka kërkuar sqarim nga njësia kërkuuese në lidhje me artikujt e kërkuar dhe të njëjtit kanë konfirmuar që artikujt në këtë procedurë të prokurimit nuk janë të njëjtë me artikujt në procedurën e prokurimit me nr. 626-24-5207-1-2-1 sikur pretendon O.E. ankues pasi që edhe pajisjet që përdoren tani në QKMF nuk janë të njëjta.

Andaj,

Duke u bazuar në atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Mamushë, me dt 05.06.2025

Gazmend Gashi
Udhëheqës i sektorit të prokurimit
Komuna Mamushë



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtroj ankesë pranë **Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP)** brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.